

V E N D I M

Nr. 14, datë 7.1.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.152, DATË 5.4.1994 “PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE
PROCEDURËN E DHËNIES SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE
DHE TË SHITESAVE TË PENSIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7709, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 5.4.1994, pika 2 ndryshohet si vijon:

“Kërkesa ose propozimi për përfitimin e pensionit të posaçëm ose të shtesës së pensionit, bëhet nga i interesuari, organizatat ose shoqatat, vetëm nëpërmjet këshillit të bashkisë ose rrethit të vendbanimit të personit si dhe nga ministritë dhe institucionet qendrore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**